



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Zyra Kryetarit



12 Nr. 069/01-16597 dt. 27/03 /2019

Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt : 27.03.2019

1. Vendim Për Aprovimin e Programit Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2019-2021, i plotësuar
2. Vendim Për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
3. Vendim Për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetin Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
4. Vendim për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2018
5. Vendim për bartjen e të hyrave vetanake për vitin 2019
6. Për formimin e ndërmarrjes publike, nga ish NP "KosovaTrans", në ndërmarrje Publike Lokale, Stacioni i Autobusëve-Gllogoc, Shoqëri Aksionare.
7. Vendim Për vendosjen e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin "Fehmi Lladrovci"
8. Vendim Për lejimin e rrënimit të objekti që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale Drenas, ish objektit për sigurime sociale




**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



12 Nr. 060/01-16597 dt. 27/03/2019

Nga :Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- z.Labinot Halilaj

Për: Kryetarin e Komunës z.Ramiz Lladrovci



LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt : 27.03.2019

1. Vendim Për Aprovimin e Programit Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2019-2021, i plotësuar
2. Vendim Për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
3. **Vendim** Për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
4. Vendim për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2018
5. Vendim për bartjen e të hyrave vetanake për vitin 2019
6. Për formimin e ndërmarrjes publike, nga ish NP "KosovaTrans", në ndërmarrje Publike Lokale, Stacioni i Autobusëve-Gllogoc, Shoqëri Aksionare.
7. Vendim Për vendosjen e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin "Fehmi Lladrovci"
8. Vendim Për lejimin e rrënimit të objekti që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale Drenas, ish objektit për sigurime sociale



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

12 Nr. 360/p1-16602 dt 27/03/2019



Në bazë të nenit 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gaz.Zyrt.e Republikës së Kosovës"), nenit 20 të Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe dispozitave tjera të këtij Ligjit, nenit 34 pika 34.6 të statutit të Komunës, Memorandumit të Mirëkuptimit Nr.400/01-41583, të datës 19.07.2018, Vendimit Nr.01-400-51039, të datës 27.08.2018, Shkresës Përcjellëse Nr.020-90/3 të datës 05.03.2019 të MAPL-së, nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.03.2019 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për Aprovimin e Programit Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2019-2021, i plotësuar

Neni 1

APROVOHET Programi Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2019-2021, hartuar nga Grupi Punues Komunal në konsultë me OJQ-DEVELOPING TOGETHER.

Neni 2

Programi ka për qëllim identifikimin e rasteve, ndihmë e sigurim të banimit për kategoritë të ndryshme qytetaresh në nevojë, për banim të përkohshëm.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, si dhe Drejtoratet përkatëse të Komunës së Drenasit.

Neni 4

Me këtë Vendim plotësohet Vendimi Nr. 360-5712, i datës 31.01.2019, vetëm sa i përket Preambulës.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Halil Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

Nr. 12-020-16571 dt 27.03 2019



Në bazë të nenit 11,12, dhe 40 dhe nenit 73 të ligjit për vetëqeverisje lokale, si dhe nenit 4, 7, 8, 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna si dhe nenit 34 pika 34.6 të statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.03.2019, aprovoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Neni 1

Më këtë Vendim Kuvendi i Komunës formon panelin përzgjedhës, i cili do të zhvilloj procedurat për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si:

1. Qendrim Mulaj- Anëtar nga Kuvendi
2. Kimete Bardhi- Anëtare nga Kuvendi
3. Beqir Kiqina- Anëtar nga Kuvendi
4. Kajtaz Kastrati- anëtar nga ekzekutivi
5. Kadire Tahiraj – anëtare nga shoqëria civile

Neni 2

Kuvendi ka për obligim të themelon panelin përzgjedhës, i cili duhet të këtë në përbërje tre anëtare të kuvendit të komunës, një anëtarë nga ekzekutivi i komunës dhe një anëtarë nga shoqëria civile, që do t'i propozojnë kuvendit të komunës listën me anëtarë për komitetin konsultativ.

Neni 3

Për zgjedhjen e anëtarëve në komitetin konsultativ Kuvendi i Komunës shpall konkurs publik dhe përcakton kriteret për konkurrim.

Neni 4


Mandati i komitetit konsultativ pas përzgjedhjes është 4 vjeçar, nga themelimi i komitetit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Labinot Halilaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

12 Nr. 111/pj- 16567 dt 27/03/ 2019



Në bazë të nenit 11,12, dhe 40 dhe nenit 73 të ligjit për vetëqeverisje lokale, si dhe nenit 4, 7, 8, 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna si dhe nenit 34 pika 34.6 të statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.03.2019, aprovoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Neni 1

Më këtë Vendim Kuvendi i Komunës formon panelin përzgjedhës, i cili do të zhvilloj procedurat për themelimin e komitetit konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si:

1. Malsore Cakiqi- anëtar nga Kuvendi
2. Petrit Sinani- anëtar nga Kuvendi
3. Sokol Bylykbashi- anëtar nga Kuvendi
4. Haki Bekolli- anëtar nga ekzekutivi
5. Behxhet Binaku- anëtar nga shoqëria civile

Neni 2

Kuvendi ka për obligim të themelon panelin përzgjedhës, i cili duhet të këtë në përbërje tre anëtarë të kuvendit të komunës, një anëtarë nga ekzekutivi i komunës dhe një anëtarë nga shoqëria civile, që do t'i propozojnë kuvendit të komunës listën me anëtarë për komitetin konsultativ.

Neni 3

Për zgjedhjen e anëtarëve në komitetin konsultativ kuvendi i komunës shpall konkurs publik dhe përcakton kriteret për konkurrim.

Neni 4

Mandati i komitetit konsultativ pas përzgjedhjes është 4 vjeçar, nga themelimi i komitetit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

Nr. 12900/01-166 dt 27.03 2019



Në bazë të nenit 11,12 dhe nenit 40, paragrafi 2. pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe neni 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën 27.03.2019 miratoi këtë:

V E N D I M
PËR RITJEN E TË HYRAVE VETANAKE PËR VITIN 2018

Neni 1

Me këtë Vendim, aprovohet rritja e të hyrave nga burimet vetanake për vitin 2018.

Neni 2

Rritja e të hyrave nga burimet vetanake për vitin 2018 aprovohet nga shuma prej: **1,577,676.00 €** në shumën prej: **1,673,969.70 €**.

Neni 3

Shpërndarja e rritjes së hyrave vetanake, do të behet sipas kategorive të shpenzimeve në projekte kapitale me shumë prej : **96.293,70€**

Investime Kapitale:

-Drejtorati për Infrastrukturë Publike (18161)në kodin funksional (0451)do të investoj në keto projekte nga rritja e të hyrave vetanake për vitin 2018.

-Asfaltimi I rrugës në Korroticë të Ultë me nr.të proj.(40029) me shumë prej.....20.850,00€

-Ndërtimi I ujësjesllsit në fsh.Abri e eperme nr,të proj.(46130) me shumë prej.....33.729,00€

-Drejtorati për Shëndetësi –Sherbime e Shendetesise Primare (73100) në kodin funksional (0721) do të financoj këto projekte me rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2018:

-Ndërtimi I QMF – së Komoran, me nr.proj.(44725) me shumë.....20.000,00€

-Drejtorati për Kulturë,Rini dhe Sportë (85001) me kod functional (0820) do të financoj këtë projekt kapital nga rritja e të hyrave.

-Renovimi i kulmit në Palestren Sportive në Drenas me numer të projektit. (I Ri) me shumë prej.....10.000,00€

-Drejtoria për Shërbime Publike,Mbrojtje Civile dhe Emergjencë(18001) me kod funksional (0451) do të financoj këtë projekt kapital nga rritja e të hyrave:

-Zgjerimi i rrjetit të kamerave në Komunën e Drenasit me nr.të proj. (I Ri) me shumë....5.000.00€

Totali në investime kapitale89.579,00€

Drejtoria për Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100) në kodin funksional (0721) do të financoj nga mallrat dhe shërbime .

- Mallra dhe shërbime (0130) me shumë prej:.....6,714.70 €

-
Totali për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2018 është me shumë prej: 96.293,70€

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset; Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe autorizuesit e programeve – nënprogrameve të buxhetit të komunës .

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labiriot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS

**Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



12 Nr. 400/p1-16592 dt 27/03/ 2019

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40, paragrafi 2. pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe neni 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën: 27.03.2019 miratoi këtë:

VENDIM

PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE NË VITIN 2019

Neni 1.

Më këtë vendim, miratohet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2017-2018 në vitin 2019. Mjetet për bartje, janë të hyrat vetanake të pa shpenzuara gjatë vitit të kaluar.

Neni 2.

Të hyrat vetanake të pa shpenzuara e që duhet të bartën janë në shumë prej: **811,638.32 €.**

Neni 3.

Shuma e mjeteve për bartje nga neni 2. i këtij Vendimi do të shpenzohet në këto kategori të shpenzimeve dhe në këto programe - nënprograme të komunës:

Mallra dhe Shërbime:

-Drejtoria për Administratë dhe Personel (163) nën-programi (16301) dhe kod funksional (0133) në kategorinë mallra dhe shërbime (0130), në shumë prej: 10,658.13 €
-Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje Civile dhe Emergjencë (180) nën-programi (18001) dhe kod funksional (0451) në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve (0130) në shumë prej: 1,826.13 €
-Shërbimet e Shëndetësisë Primare Shëndetësore (730) nën-programi (73100) me kod funksional (0721) në kategorinë Mallra dhe Shërbime (130) dhe shumë prej: 9,811.97€ --

-- Arsimi Parashkollor dhe çerdhet (920) nën-programi(92210) dhe kod funksional (0911) në kategorinë Mallra dhe Shërbime në shumë prej: 10,162.80 €
Gjithsej mallra dhe shërbime..... 32,459.03 €

Shërbime Komunale:

-Drejtorati për Administratë dhe Personel (163) nën-programi (16301) dhe kod funksional (0133)në kategorinë Shpenzimeve komunale (0140),në shumë prej: 1.41 €
Gjithsej shërbime komunale.....1.41 €

Subvencione-transfere:

-Zyra e Kryetarit (160) nën-programi (16001) me kod funksional (0111) në kategorinë Subvencione dhe transfero (200) në shumë prej 3,403.50€
 -Drejtorati për Administratë dhe Personel (163) nën-programi (16301) dhe kod funksional (0133) në kategorinë Subvencione dhe Transfere (200),në shumë prej: 830.00 €
 -Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje civile dhe Emergjencë (180) nën-programi(18001) dhe kod funksional (0451) në kategorinë e Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej: ...2,795.00 €
 -Drejtorati për Bujqësi Pylltari dhe zhvillim Rural(470) nën-program (47001) me kod funksional (0421) në kategorinë Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej: 8,260.40 €
 -Drejtorati I Administratës Shëndetësi (730) nën-programi (73010) dhe kod funksional (0760) në kategorinë Subvencione dhe Transfere(200) në shumë prej:..... 7,821.76 €
 -Drejtorati për kulturë rini dhe sport (850) nën-programi (85001) me kod funksional (0820) dhe shumë prej: 500.00 €
 -Drejtorati I Administratës Arsim (920) nën-programi (92005) dhe kod funksional (0980) në kategorinë Subvencione dhe Transfere (200) dhe në shumë prej: 243.90 €

Gjithsej Subvencione-transfere..... 23,854.56 €

Shpenzimet Kapitale:

Në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshëm (163)nën-programi (16301) dhe kod funksional (0133)do të bartën këto mjete sipas projektit kapital:

- Renovimi i ZGJC në Terstenik dhe Komoran kodi projektit (44733) burimi I financimit (22) shuma prej:..... 639.00 €

Në programin Shërbimet Publike dhe punë Emergjente (180) nën-programi (18001) me kod funksional (0451) do të bartën këto mjete sipas projekteve kapitale:

- Rregullimi I varrezave në Komunën e Drenasit me kod projekti (89016)burim financimi (21) dhe shumë prej:.....12,294.00 €,
- Zgjerimi i rrjetit të kamerave në komunën e Drenasit nr. Proj (i ri) 5,000.00 €.

Totali I investimeve kapitale Sherb.pub.dhe emergj.....17,294.88 €.

Në programin Shërbimeve Kadastrale dhe punë Gjeodezike (650) nën-programi(65005) dhe kod funksional (0610) do të bartën këto mjete sipas projekteve kapitale

Elaborati katastral I komunës me kod të projektit (40009) bur.f .21 dhe shumë prej :... 759.36 €

Nga programi Planifikimi Urban dhe Mbrojta e Mjedisit (Kodi 66310), do të bartën në programin e ri **Infrastrukturë Publike** (181) nën-programi (18161) dhe kod funksional (0451) këto mjete sipas këtyre projekteve kapitale:

- Asfaltimi i rrugës në fshatin Korroticë e Ultë (kodi 40029), shuma prej:.....	26,120.00€,
- Ndërt. i kapac. të ujsjellsit (kamenicë) Drenas (kodi 44509) shuma prej:..	73,499.21 €
- Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobroshec,Qik.Vjeter (Kodi 48638), shuma:..	33,736.90 €
- Ndërtimi i Tombinave – ujrave në komunën e Drenasit (kodi 44770),shuma:	64,000.00 €
- Ndërtimi i Infrastrukturë(asfaltim dhe kubza) Drenas nr.pr(46094),shumë:....	8,855.00 €
- Ndërtimi i kapaciteteve të ujësjellsit (kod 48661) shuma	20,000.00
- Asfaltimi i rrugës në fshatin Gllanasel, Godanc(kod 48632) shuma	10,327.28 €
- Kanalizimi i ujrave të zeza në Fshatin Verbovc (46115) shuma	11,997.90 €
- Bashkëfinancim i projekteve me donator të Jashtëm (kod 46126) shuma ...	4,498.52 €
- Bashkëfinancim i projekteve me donator të Jashtëm (kod 48682) shuma prej	6,376.07 €
- Ndërtimi i Ujsjellsit në fsh.Abri e eper (kod 46130) shuma	38,314.91 €
- Rregullimi i Trotuarit në fsh.Domanek (kod 46131) shuma	3,000.00 €
- Kanalizimi i ujrave të zeza në Fshatin Llapushnik (kod 46148) shuma.....	35,737.89 €
- Ndërtimi i Urave dhe Tombinave (kod 48631) shuma	59,865.59 €
-Ndërtimi i trotuarit Krajkovë-Drenas(kod 89055) shuma.....	2,656.75€
- Ndërtimi i shtëpive për skamnor(kod 89096) shuma.....	1,869.60€
-Asfaltimi i rrugës fshati Arllat(kod 48646)shuma.....	21,917.03€
-Ndërtimi i shtëpive për skamnor(kod 48681) shuma.....	6,985.67€
Gjithsej Infrastruktura Publike	429,758.32 €

Në programin Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor (QKMF) (730) nën-programi (73100) dhe kod funksional (0721) do të bartën këto mjete.

Renovimi I AMF Sankoc me (kod 46041) dhe shumë prej :.....	8,376.50 €
Ndërtimi I QMF Komoran me kod (44725) dhe shumë prej:.....	28,400.00 €
Paisje Mjekësore me kod (46044) dhe shumë prej:.....	14,059.00 €
Paisje Mjekësore (USG,Monitor,AP për 02) me kod (44726) dhe shumë prej:.	560.00 €
Zgjerimi I QMF Gllanasell me (kod 44729) dhe shumë prej:.....	13,328.40 €
Totali I Shërbimeve primare Shëndetësore:.....	64,723.90 €.

Në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport (850) nën-programi (85001) dhe kod funksional (0820)do të bartën këto mjete:

Ndërtimi I Stadionit Faza e dytë me kod (89114) dhe shumë prej:100,948.04 €

Renovimi I Kulmit në Palestrën sportive Drenas (Hysni Jetullahu) me nr.projektit (I Ri) me shumë prej :..... 10,000.00 €

Totali I Kulturës, Rinisë dhe Sportit :..... 110,948.04 €

Në programin e Administratës së Arsimit (920) nën-program (92005) do të bartën këto mjete

Renovimi (I Aneksit I vjetër SHFMU Dëshmoret e Qëndresës me (kod 44893) dhe shumë prej: 33,706.00 €

Inventarizimi I shkollave në Drenas me (kod 45082) dhe shumë prej:..... 50,000.00 €

Rrethojat e SHFMU Rasim Kiqina Paralelja ne Poklek me (kod 46050) në shumë... 20,000.00 €
Sërvisimi I pasjeve tjera (nxemja Qendrore) te shkolla me (kod 46068) në shumë... 650.00 €
Renovimi dhe rikonstruimi I objekteve shkollore Drenas me (kod I ri)..... 10.000.00 €
Rregullimi I rrethojës për SHFMU Rilindja Dobroshec me (kod 44878) në shumë 16,844.15 €

Totali I Administratës Arsimit 131,200.04 €

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labiriot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 401/01-16582 dt 27.03/ 2019

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040 si dhe nenit 16 paragrafi 16.1, nenit 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 35 paragrafi 35.1 të Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, nenit 34 pika 34.6 të statutit të Komunës së Drenasit Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.03.2019, aprovoi këtë:

VENDIM

I

Për formimin e ndërmarrjes publike, nga ish NP "KosovaTrans", në ndërmarrje Publike Lokale, Stacioni i Autobusëve-Gllogoc, Shoqëri Aksionare.

II

NPL Stacioni i Autobusëve - Gllogoc, Shoqëri aksionare, do të veprojë si ndërmarrje publike, me asete 100% të Komunës së Gllogocit.

III

NPL Stacioni i Autobusëve - Gllogoc, Shoqëri aksionare, duhet të këtë këshillin drejtues, i cili do të menaxhoj me punët e operimit dhe financimit.

IV

Këshilli drejtues duhet të përbehet nga pesë (5) anëtar, ku një prej tyre duhet të jenë nga ekzekutivi i Komunës, dy nga Kuvendi i Komunës dhe dy nga NPL SH.A Stacioni i Autobusëve - Gllogoc.

V

Këshilli drejtues duhet të zgjedh kryetarin e këshillit drejtues, dhe njëherit të hartoj Statutin e NPL SH.A Stacioni i Autobusëve - Gllogoc.

VI

Kuvendi i Komunës ka të drejtë që kur e sheh të nevojshme, të shpallë NPL SH.A Stacionin e Autobusëve - Gllogoc, si të mbyllur dhe ta jap me koncesion apo me Partneritet Publiko-Privat (PPP).

VII

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

12 Nr. 353/01-16591 dt 27/03/2019



Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 98 të Statutit të Komunës së Glllogocit, Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë; 27.03.2019 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për vendosjen e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin "Fehmi Lladrovci"

Neni I

Me këtë Vendim, kërkohet që të na lejohet vendosja e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin "Fehmi Lladrovci"

Neni II

Vendosja e shtatoreve do të bëhet brenda sheshit "Fehmi Lladrovci" në lokacionin e përcaktuar nga ana e komisionit, i cili do të merret me caktimin e lokacionit për vendosje të shtatoreve.

Neni III

Të gjitha shpenzimet sikurse për punimin e shtatoreve ashtu edhe për vendosjen e bazamenteve do të bëhet me anë të donacioneve.

Neni IV

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

Nr. 12.354-16564 dt 27.03 2019



Në bazë të nenit 11,12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 98 të Statutit të Komunës së Glllogocit, kërkesës së drejtorisë së Inspeksionit Nr. 11-354-15308, të datës 20.03.2019, Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.03.2019 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për lejimin e rrënimit të objekti që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale Drenas, ish objektit për sigurime sociale

Neni I

Me këtë Vendim, kërkohet që të na lejohet rrënimi i objektit që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale Drenas, ish objektit për sigurime sociale.

Neni II

Rrënimi i objektit që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale Drenas, ish objektit për sigurime sociale, do të mbikëqyret nga ana e personave përgjegjës në Komunën e Drenasit .

Neni III

Të gjitha shpenzimet e rrënimit për objektin e lartcekur, do të bien në drejtorinë e Inspeksionit.

Neni IV

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labiriot Halilaj

